[Shqiptarja.com]

E martë 10 Janar 2023 - Përditësimi i fundit 22:38

Kërko

LIVE [Shqiptarja.tv]

HOME EDICIONET LOKALE KRONIKË POLITIKË SHËNDETI EKONOMI SPORT KOSOVË & RAJONI BOTË KULTURË EDITORIAL OPINION

TË FUNDIT SOCIALE DREJT PUNËS SPECIALE LIFESTYLE VIP & SPEKTAKËL RECETA HOROSKOPI DOSJE FOTOGALERI VIDEOGALERI PIKË E ZEZË SONDAZHE

POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

4 Ilir Shaqiri për Luiz Ejllin: Vajzë e mirë, e kam komshie

5 Luizi 'gënjeu' për tumorin, Kiara e mbështet: Mos ma nxirrni nga shtëpia, nuk rrihet pa të


1 Është apo nuk është sëmurë? Luiz Ejlli 'i dyzuar' për vuajtjen nga tumori: Kjo gjë u bë e madhe! Banorët 'kryqëzojnë' këngëtarin


2 Fundi i një epoke, Diego Simeone largohet nga Atletico Madrid


3 Natën e Vitit të Ri i iku nënës nga duart, humbet i mituri nga Vlora! Qytetari e dorëzoi në komisariat, policia e lë të lirë

Kronikë

Me arsenal armësh me vete dhe i veshur me antiplumb, arrestohet djali i oficeres së ushtrisë në Lezhë: Isha nisur për të vrarë politikanët

Një 36-vjeçar u arrestua nga policia e Lezhës në bashkëpunim me Shqiponjat, pas paralajmërimeve e do të kryente një krim të rëndë. I denoncuar nga i vëllai, Antonio Leka i ka thënë policinë se do të vriste disa politikanë, ndërsa nuk dihet ende nëse i riu vuan nga probleme të shëndetit mendor apo ishte nën efektin e lëndëve narkotike

- Me automatik në dorë dhe qeleshe në kokë, del fotoja e 36-vjeçarit në Lezhë pak minuta para arrestimit
- Kush është Antonio Leka, 36-vjeçari që u kap me arsenal armësh në Lezhë! Djalë i një oficerje të ushtrisë
- VIDEO/ Me municion luftarak në makinë për të vrarë politikanët, këto janë pamjet e arrestimit të 36 vjeçarit në Lezhë

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Elvis Hila
9 Janar, 18:51 | **Përditesimi: 9 Janar, 22:58**

LEZHË- Një ngjarje e mundshme kriminale u parandalua në Lezhë, teksa 36-vjeçari Antonio Leka u kap me një arsenal armësh zjarri, armë të ftohta, vjedhje kamuflazhi e sende të tjera.

Ka qenë vëllai i Antonios, Nik Leka, që ka njoftuar policinë e Lezhës, për prezencën e tij të armatosur, i cili kishte parë të vëllain të veshur ushtarak dhe me një jelek anti-plumb. Policia lokale e vlerësoi me shpejtësi këtë informacion, duke rrethuar Antonio Lekën dhe ndaluar në aksin rrugor Milot-Lezhë, pranë ishull Shëngjinit.

LEXO EDHE:
Zjarr në bllokun e sistemit elektrik të një pallati në Lezhë! Banorët në panik (VIDEO)

Gjatë kontrollit të ushtruar në makinën e tij, policia ka gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale: 1 armë zjarri pistoletë me 5 karikatorë, 1 automatik me 5 karikatorë, 550 fishekë luftarakë për pistoletën dhe automatikun, 1 palë dylbi, 1 antiplumb ushtarak, 1 thikë, 1 çantë ushtarake, 75 gramë lëndë e dyshuar narkotike kanabis dhe rroba kamuflazhi.

Gjatë momentit të arrestimit Antonio Leka, nuk ka shfaqur rezistencë ndaj punonjësve të policisë, por u ka thënë këtyre të fundit se ishte nisur në drejtim të Lezhës, për të vrarë politikanët.

'Do vras politikanët e Lezhës, dhe të zhduk farën e keqe të tyre' -ka pohuar Leka. Antonio Leka është djali i një oficerje ushtrie, Davë Leka.

Report Tv mëson se nuk përjashtohet se i riu të ketë probleme të shëndetit mendor apo të ketë qenë nën efektin e lëndëve narkotike, megjthatë në gjykatë ai do të përballet me akuzat "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit", "Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike", "Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta" dhe "Përgatitja e kushteve për vrasje".

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 22:45

Me automatik në dorë dhe qeleshe në kokë, del fotoja e 36-vjeçarit në Lezhë pak minuta para arrestimit



Report Tv ka siguruar foton e 36-vjeçarit Antonio Leka pak minuta para arrestimit. Ai është parë me automatik në dorë dhe me qeleshe në kokë brenda një servisi makinash në Ishull-Lezhë. 36-vjeçari kishte një arsenal armësh me vete dhe gjatë momentit të arrestimit nuk ka bërë rezistencë. Ai ka deklaruar se ishte nisur për të vrarë politikanët.

Ora 21:01

VIDEO/ Me municion luftarak në makinë për të vrarë politikanët, këto janë pamjet e arrestimit të 36 vjeçarit në Lezhë

Policia ka dalë me njoftim zyrtar për arrestimin e 36 vjeçarit, Antonio Leka i cili është kapur me arsenal armësh brenda makinës së tij në Lezhë. Sipas policisë, bëhet me dije se kanë qenë banorët ata që kanë lajmëruar oficerët se 36 vjeçari donte të kryente një krim dhe për këtë arsye ishte armatosur.

Gjatë kontrollit të ushtruar në automjetin e tij, policia ka gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale: 1 armë zjarri pistoletë me 5 karikatorë, 1 automatik me 5 karikatorë, 550 fishekë luftarakë për pistoletën dhe automatikun, 1 palë dylbi, 1 antiplumb ushtarak, 1 thikë, 1 çantë ushtarake, 75 gramë lëndë e dyshuar narkotike kanabis dhe rroba kamuflazhi.

Ndërkohë policia e ka konsideruar si sekret hetimor motivin e 36 vjeçarit i cili kishte mbushur makinën e tij plot me municione luftarake, duke mos zbuluar detaje mbi objektivin e synuar nga i arrestuari.

Ora 20:35

Kush është Antonio Leka, 36-vjeçari që u kap me arsenal armësh në Lezhë! Djalë i një oficerje të ushtrisë



Report Tv ka siguruar foton e Antonio Lekës, 36-vjeçarit i cili u arrestua nga policia e Lezhës mbrëmjen e sotme pasi u kap me arsenal armësh dhe i veshur me antiplumb. Antonio Leka është djali i një oficerje ushtrie Davë Leka. Gjatë momentit të arrestimit Antonio Leka, nuk ka shfaqur rezistencë ndaj punonjësve të policisë, por u ka thënë këtyre të fundit se ishte nisur në drejtim të Lezhës, për të vrarë politikanët.

Ora 20:07

U kap me armë gati për qitje në makinë, 36-vjeçari: Isha nisur për të vrarë politikanët e Lezhës



Antonio Leka, një person nga qyteza e Milotit në Kurbin, i dënuar me parë nga gjykata, për "Prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike", është arrestuar nga policia e Lezhës, pasi në makinën e tij, u gjetën dhe sekuestruan një arsenal i tërë me armë luftarake.

Ka qenë vëllai i Antonios, që ka njoftuar policinë e Lezhës, për prezencën e tij të armatosur, i cili kishte parë të vëllain të veshur ushtarak dhe me një jelek anti-plumb. Policia lokale e vlerësoi me shpejtësi këtë informacion, duke rrethuar Antonio Lekën dhe ndaluar në aksin rrugor Milot-Lezhë, pranë ishull Shëngjinit.

Gjatë momentit të arrestimit Antonio Leka, nuk ka shfaqur rezistencë ndaj punonjësve të policisë, por u ka thënë këtyre të fundit se ishte nisur në drejtim të Lezhës, për të vrarë politikanët. *"…do vras politikanët e Lezhës, dhe të zhduk farën e keqe të tyre…"* - ka pohuar Leka, policia ende nuk ka dalë me një njoftim zyrtar në lidhje me këtë operacion, ndërsa nuk përjashtohet mundësia që i ndaluari të ketë dhe probleme të shëndetit mendor.

M.Q./Shqiptarja.com

TAG: antonio leka | policia e lezhes | Lezhe | municione luftarake

Komento

Komente

Begu: 10/01/2023 10:10

I vogel me vjet dhe me trup.Shume i cvogel me mendime dhe rezonime.Me se shumti i vogel me guxim e trmeri.

Përgjigju

Leah: 10/01/2023 09:07

Me thene te drejten vetem fytyre krimineli nuk ka. Nje fytyre kaq e bukur nuk mund te jete kurre i keq ne shpirt. Duhet pare gjendja psikologjike e tij dhe shkaqet

Përgjigju

Artan: 10/01/2023 06:42

Po pse te Lezhes,o cun,po ata te Tiranes,ta kishe pastruar pak nga ato ndyresira.

Përgjigju

Axemi: 10/01/2023 06:33

Ah moj Shot. Ti dhe Ai vllai jot kurv, shkoni boni cicin nashi, se ta kishe pas primen e kishe bo

Përgjigju

Iris: 10/01/2023 02:36

Kur hapet kjo /can of worms/,mos u cudisni per pasojat.Grushti qe hengri Saliu theu mitin e /paprekshmerise/ se politikaneve e sidomos ne nje shtet si Shqiperia,ku populli urren politikanet e sotem e i quan fajtore e shkaktare per keto 32 vjet /Dark Ages/ e ku duken te paprekshem nga drejtesia,krijon ambjent qe keto incidente te perseriten.

Përgjigju

leta: 09/01/2023 22:47

pse nuk le late te lante ca hale e te qerronte ca qe te shpetonte shqiperia

Përgjigju

Emer Mbiemer: 09/01/2023 22:17

Ne fakt kush e njeh kete djalin, e di se sa zotni e sa djale trim eshte. Ky eshte viktime e rrethanave dhe e shoqerise ku jetojme. Uroj qe institucionet e miqte ti qendrojne prane ne kete dite te veshtira.

Përgjigju

> **Lezhjani:** 09/01/2023 23:09
>
> Ke shum te drejte se e njeh e gjithe lezha edhe nuk e meriton te trajtohet si kriminel e si njeri rruge e te komentohet nga lloj lloj lastroku neper faqe lajmesh e port-halesh. Shpresoj qe gjykata dhe prokuroria te marre parasyshe gjendjen e renduar te Novit qe vjen si pasoje e rrethanave ne te cilat e la shteti pasi e perdori sa her ju desht

Populli: 09/01/2023 21:22

Do zoti e d

Përgjigju

Olsi: 09/01/2023 21:15

Perse na e late te hiqte qafe disa mbeturina.

Përgjigju

Daku: 09/01/2023 21:12

Po cpate mor tu thaft dora qe spiunove

Përgjigju

Ncnc: 09/01/2023 20:55

Po pse nuk e lat mor ? Vetem nji njeri kshu e shpeton shqiperin po vravi disa politikan

Përgjigju

Lezha: 09/01/2023 20:51

Ky esht Nov Leka nder djemt ma trima te lezhes po lenja jasht cdo pune dhe rrespekti qe i takonte pas gjith sakrificave qe ka ber per partin socialiste te lezhes e qoj ne nje gjendje te renduar psikologjike por asnje qellim te till ska pasur as te vras e as te demtoje njeri kto jan inskenime

Përgjigju

PSE se lat mer: 09/01/2023 20:19

PSE se lat mer.te marote pun ne lezh a te vazhdonte ne tiron masanej

Përgjigju

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Do zbulohet origjina e parave të gjetura në banesën e pastrueses?

Po | Jo | Nuk kam mendim

Lajme të tjera

FOTOT/ Shkolla 9-vjeçare 'Gjon Gjonaj' në Laç hap dyert për nxënësit, Rama: Transformim rrënjësor në zonën më të prekur nga tërmeti

10 Janar, 11:13

VIDEO/ Momenti kur 'Rambo' i Lezhës bën prova me kallash para se të nisej për të 'vrarë' politikanët! Fqinja: Nuk është problematik! Jep dëshmi kontradiktore në prokurori

Elvis Hila

10 Janar, 10:41

Rrëshqitje dherash në Postribë, bllokohet aksi Mes-Ura e Shtrenjtë! Përmbytet lagjja 'Besëlidhja' në Lezhë! Pezullohet linja e trageteve Durrës-Bari dhe anasjelltas

10 Janar, 07:51



VIDEO/ Me municion luftarak në makinë për të vrarë politikanët, këto janë pamjet e arrestimit të 36 vjeçarit në Lezhë

9 Janar, 21:01

Kush është Antonio Leka, 36-vjeçari që u kap me arsenal armësh në Lezhë! Djalë i një oficerje të ushtrisë

9 Janar, 20:35

U kap me armë gati për qitje në makinë, 36-vjeçari: Isha nisur për të vrarë politikanët e Lezhës

9 Janar, 20:07

Privati rrit taksën në tregun e Lezhës, tregtarët: E papërballueshme, jemi drejt falimentimit

Elvis Hila

9 Janar, 14:29

Prej vitesh polic bashkiak në Lezhë por ëndrrën për muzikën s'e braktis, Jak Gegaj rrëfen punën dhe pasionin, nga shërbimi për njerëzit te kënga popullore

Elvis Hila

8 Janar, 18:53

Lezhë, 500 banorë në periferi nuk furnizohen rregullisht me ujë, rrjeti shpërndarës i amortizuar! Qytetarët: E blejmë me bidonë

Elvis Hila

8 Janar, 17:16

Furgoni përplaset me shtyllën, fshati Dajç mbet pa drita! OSSH po punon për rikthimin e energjisë

8 Janar, 16:43

Pensionistët 'dynden' për të tërhequr bonusin e akorduar nga qeveria! Radhë e gjatë të moshuarish në Lezhë dhe në Tiranë (VIDEO)

6 Janar, 11:07

I plasi goma e kamionit ndërkohë që po e frynte, publikohet FOTO e 56 vjeçarit që ndërroi jetë mëngjesin e sotëm

6 Janar, 09:32

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje